



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 03/2prot

Datë 05.01.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT TË OPERATORIT EKONOMIK**  
**ANKIMUES DHE PRETENDIMET MBI OFERTUESIT E TJERË**

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Deja” SHPK në procedurën e prokurimit “*Shërbim konsulence*”, me Nr. REF-47713-10-27-2022 me objekt “*Plan mbarështimi i pyjeve dhe kullotave, Bashkia Vorë*” me fond limit: 3.330.000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 21.12.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vorë

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatorët ekonomikë “*Lurimi*” shpk dhe “*Gjelbërimi 2000*”shpk në procedurën e mësipërme të prokurimit.

**Ankimues:**

Operatori ekonomik “Deja” SHPK  
*Adresa: Rr. “Strasburgu”, Nr. 21 Kamëz, Tiranë*

**Autoriteti Kontraktor:**

Bashkise Vorë,  
*Adresa: Rruga “Unaza” Nr.2, Vorë*

**Subjekte të Interesuara:**

Operatori ekonomik “Lurimi” shpk  
*Adresa: Dibër MAT Burrel L DRITA*

Operatori ekonomik *GJELBËRIMI 2000*” shpk  
*Adresa: Tirane Kamëz Lagja Valias, Rruga Automobilistike Kamëz, Ura e Tapizës, km.3, nr.kadastrë 45/16, nr.pasurie 1*

Në datën 04.01.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 03/2023 protokoli e operatorit ekonomik “Deja” SHPK për procedurën e prokurimit “Shërbim konsulence”, me Nr. REF-47713-10-27-2022 me objekt “Plan mbarështimi i pyjeve dhe kullotave, Bashkia Vorë” me fond limit: 3.330.000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 21.12.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vorë

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Deja” SHPK si dhe kualifikimin e shoqërive “Lurimi” shpk dhe “Gjelbërimi 2000”shpk.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: *“Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”*

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Deja” SHPK, e cila kundërshtohet në ankesën me nr. 03 prot, datë 04.01.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

*1. OE nuk ka sjelle dokumentin provues te pikës 2.3.4 të formularit të kriterëve re përzgjedhjes sipas Shtojcës 11, që lidhet me kontratat individuale te punës. Konkretisht, OE nuk disponon kontrata individuale te punes qe tregojne nje marredhenie juridike ne fuqi midis tij dhe punëmarrësve specialist në profilet e kërkuara ne piken 2.3.4. Kontrata e vënë në dispozicion nga subjekti është një kontratë premtim-angazhimi, e cila nuk rregullohet nga legjislacioni në fuqi dhe nuk ka garanci zbatueshmërie për palën e tretë, në këtë rast për AK, që OE do ti kontraktojë gjatë kohës së hartimit të planit apo që palët midis tyre do të mund të bien dakord për kushtet thelbësore më pas në nënshkrimin e kontratës përfundimtare të punës dhe në angazhimin reciprok. 2. Gjithashtu në dosjen e OE mungojnë Librezat e punës per nje pjese te stafit kjo ne kundërshtim me piken 2.3.4 te kriterëve te vecanta,.*

Gjithashtu Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret të cilat operatori ekonomik ankimues “Deja” SHPK, pretendon se nuk përmbushen nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurë “Lurimi” shpk dhe “Gjelbërimi 2000”shpk.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushje nga ana e operatorit ekonomik “Gjelbërimi 2000”shpk. të kriterit/ve si më poshtë vijon:

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1.** *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.*

*Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:*

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për operatorin ekonomik “Lurimi”shpk si më poshtë vijon: “[...]Operatori ekonomik “Lurimi”shpk ka fituar 5 tendera për mbarëshitim pyjesh me të njëjtin staf teknik si në Përmet Shkodër, Mirditë, Dropull dhe Vlorë dhe i ka të gjitha kontratat të papërfunduara dhe nuk ka mundësi të realizohen 5 objekte pune me të njëjtin staf dhe aq më keq kur i ka fituar me ofertë më të ulët se 25% të fondit limit të gjithë këto tendera. Këtu bie era korrupsion i gjallë dhe moskryerje të kontratës sipas kriterëve teknike dhe ligjeve në fuqi[...]

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 05.01.2023

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**